



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-5262/1 datë 26.11.2021, për ndërtimin e objekteve të banimit në-----, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-5262/1 të datës 26.11.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur , gjegjësisht një grup qytetarësh nga rruga----- nga -----, më datë 26.11.2021 është dorëzuar denoncim për. personin në lidhje me ndërtimin e objekteve të banimit në rrugën ku banojnë dhe është formuar lënda me numër 12-5262 i vitit 2021. Në denoncim, parashtruesi thekson se për një periudhë të gjatë kohore, pra duke filluar nga viti 2018 e në vazhdim, në rrugën "----- janë ndërtuar intensivisht disa objekte banimi". Deri më tani janë ndërtuar tre objekte, ndërsa ndërtimi i objekteve të reja të banimit është duke u zhvilluar.

Parashtruesi thekson se për shkak të punimeve ndërtimore të cilat kryhen të lokacionin e përmendur në -----, ka dëmtime në vet rrugën por edhe zhvendosje të tokës.

Parashtruesi kërkon që KSHPK-ja të kryejë inspektimin dhe kontrollin e punës së Komunës----- në fushën e mundësimit të ndërtimit të këtyre objekteve të banimit në

vendndodhjen e përmendur, si dhe të gjitha objekteve të tjera që janë ndërtuar në ----- ---- në periudhën e kaluar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në denoncim bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti: K.Z

KOMISIONI SHTETËTORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska

